



SEECP ALBANIAN CHAIRMANSHIP
REGIONAL OWNERSHIP IN ACTION

Konferenca Rajonale për një Qeverisje të Mirë dhe Anti-korrupsioni Sfidat e Politikës

Tiranë, 13-14 nëntor 2014

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore / Koordinatori Kombëtar për Anti-korrupsion, i Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), dhe Nismën Rajonale për Anti-korrupsion (RAI), organizuan në Tiranë, në datat 13 -14 nëntor 2014, Konferencën Rajonale me temë: “Për një Qeverisje të Mirë dhe Sfidat e Politikave Anti-korrupsionit”.



Konferenca u zhvillua në dy panele tematike: “Monitorimi i Korrupsionin dhe Anti-korrupsion në Evropën Juglindore: sfidat e politikës dhe roli i shoqërisë civile” dhe “Parandalimi i Korrupsionit përmes vlerësimit të rrezikut të tij”.

Konferenca ishte pjesë e kalendarit të aktiviteteve të Kryesisë Shqiptare të Proçesit të Bashkëpunimit të vendeve

të Evropës Juglindore (SEECP). Në të morrën pjesë krerë të agjensive anti-korrupsion, ekspertë dhe zyrtarë të lartë të angazhuar me problematikat e anti-korrupsionit nga të gjitha vendet e Evropës juglindore, si dhe nga Gjermania, Lituania, përfaqësues të Komisionin Evropian, etj. Një vlerë të shtuar solli pjesëmarrja në diskutime e organizatave rajonale të Shoqërisë Civile, aktive në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe të qeverisjes së mirë.

Konferenca u hap nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore i Republikës së Shqipërisë, në rolin e tij si Koordinator Kombëtar për Anti-korrupsionin.

Konferenca u përshëndet gjithashtu nga Drejtori i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Z. Sokol Gjoka.

Konferenca i shërbeu shkëmbimit të praktikave më të mira, eksperiencave dhe përvojave ndërmjet vendeve, nxitjes së bashkëpunimit rajonal në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Gjatë punimeve të saj, ekspertët dhe zyrtarët shkëmbyen ide për të konsoliduar shkëmbimin e informacioneve në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe lidhjeve të tij me krimin e organizuar.

Për më shumë klikoni [këtu](#)